

VENDIM
Nr.1222, datë 11.12.2009

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës “a” të pikës 1, shtohen emërtesat “... Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian dhe Qendra Kombëtare për Aplikimet Energjetike.”.

b) Lidhja nr. 1, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pagat e punonjësve të tjerë mbështetës të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, dhe Qendrës Kombëtare për Aplikimet Energjetike, përcaktohen sipas vendimit për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

3. Efektet financiare, për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për këto institucione për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET
QENDRORE TË GRUPIT TË PARË

PAGA MUJORE					
Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-a	12 000	2%		105 000
Z/titullar i institucionit. Inspektor në Agjensinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi European	II-b	12 000	2%		88 000
Drejtor Drejtorie. Anëtar i Komitetit Shtetëror të Kulteve. Menaxher trajnimi	III-a	12 000	2%		69 000
Përgjegjës sektori	III-a/1	12 000	2%		60 000
Përgjegjës sektori. Inspektor	III-b	12 000	2%		52.000
Specialist	IV-a	12 000	2%		41.000
	IV-b	12 000	2%		31 000